



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 242, Datë 02.12.2021

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBESP TRADING & CONSULTING” SH.P.K.,
NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1, gërma “e”, nenit 13, të Rregullores për procedurat dhe afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15, të Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 02.12.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr.145/3 prot., datë 25.11.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 227, datë 09.11.2021, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.
- ERE me shkresën nr. 6/22 prot., datë 10.11.2021, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët, nuk rezultoi të ketë të tilla.
- Shoqëria me shkresat nr. 1021/2 prot. dhe nr. 10.21/3 prot., datë 15.11.2021, ka përcjellë ne ERE dokumentacionin e munguar të këtij aplikimit i cili është reflektuar respektivisht si më poshtë sqaruar në vendim.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike nga ERE, në zbatim të Aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”.

- Dokumentacioni i këtij aplikimi është tërësisht i plotësuar në zbatim të kërkesave të “Rregullores për Proçedurat dhe Afatet për Dhenien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, si më poshtë vijon:
 - Formati dhe dokumentacioni për aplikim; neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”. **Plotësuar.**
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor; neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”. **Plotësuar;**
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal; neni 9, pika 3, gërma “a”, “b”, “c”, “d”. **Plotësuar;**
 - Dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike; neni 9, pika “a”, “b”, “c”. **Plotësuar.**

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI